

Udhëzime për plotësimin e formularit EUR.1

Numri i kutisë	Përshkrimi	Informacioni i kërkuar	Komente
1	Eksportuesi	Emri, adresa e plotë dhe vendi	Eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të jetë i vendosur në RSh. Formulari i aplikimit duhet të shoqërohet me të gjitha dokumentet mbështetëse që vërtetojnë plotësimin e rregullit që është në fuqi për përfitim të origjinës preferenciale. Dokumentet mbështetëse duhet të paraqiten dhe të mbahen në dosje në zyrën doganore të lëshimit të certifikatës në rast të kërkesave pas zhdoganimit nga autoriteti doganor importues.
2	Certifikatë e përdorur në tregtinë preferenciale midis SHQIPERISE dhe	Emri i vendit, apo i grupeve të vendeve ose territoreve ku eksportohen mallrat	Mund të shkruhet emri i plotë i vendit, ose kodi Iso Alpha i tij.
3	Importuesi	Emri, adresa e plotë dhe vendi (Opsionale)	Nuk është e detyrueshme ta plotësoni këtë rubrikë.
4	Vendi, grupi i vendeve ose territori ku produktet konsiderohen si origjinuese		Duhet të shkruhet: Shqipëri, nëse mallrat konsiderohen si origjinuese në vendin tonë. ose Në rastet e kumulimit, kur mallrat ruajnë origjinën e tyre, shkruhet emri i palës kontraktuese në Konventën PEM apo në marrëveshjen e tregtisë së lirë. Informacionin për Konventën e gjeni: https://dogana.gov.al/d/182/249/0/264/konventa-pan-euro-mesdhetare-e-rregullave-te-origjines-preferenciale
5	Vendi, grupi i vendeve ose territori i destinacionit		Mund të shkruhet emri i plotë i vendit, të destinacionit ose kodi Iso Alpha i tij.
6	Detaje të transportit	Opsionale	Nuk është e detyrueshme ta plotësoni këtë rubrikë.
7	Shënimet	Kjo kuti lihet bosh, përveç rasteve kur bëhet	

		e nevojshme sipas miratimeve të mëposhtme: “DUPLICATE” “ISSUED RETROSPECTIVELY” “CUMULATION APPLIED WITH”	Shkruhet Duplicate: në rast të vjedhjes, humbjes, apo shkatërrimit të një certificate lëvizjeje EUR.1, ju mund të aplikoni për një dublikatë pranë autoriteteve doganore që e kanë lëshuar atë – duhet të shpjegoni arsyen. Dublikata duhet të mbajë datën e lëshimit të certifikatës origjinale të lëvizjes EUR.1, pasi ajo do të hyjë në fuqi që nga ajo datë. Shkruhet Issued Retrospectively: nëse mallrat janë larguar nga vendi para se të bëni kërkesën për një certifikatë lëvizjeje EUR.1. Në aplikim, në nën paragrafin 1 të faqes 4 duhet të shkruani ‘nuk është lëshuar më parë asnjë certificate për këto mallra’; nëse e keni paraqitur pranë autoriteteve doganore një certifikatë EUR.1 që është lëshuar më parë, por nuk ju është pranuar gjatë importimit për arsye teknike; apo nëse keni ndonjë arsye tjetër, Në aplikimin tuaj duhet të tregoni vendin dhe datën e eksportit të produkteve me të cilat lidhet certifikata e lëvizjes EUR.1, dhe të tregoni arsyet për këtë kërkesë. Duhet të vendosni emrin e Palës/Palëve kontraktuese përkatëse, kur produktet marrin statusin origjinues me anë të zbatimit të kumulimit të origjinës në përputhje me Konventën e Rishikuar PEM. Matrica PEM duhet të konsultohet për t’u siguruar që ekziston me të vërtetë një mundësi kumulimi me vendet e përfshira në tregti. https://dogana.gov.al/dokument/5766/skema-e-kumulimit-pem
8	Numri i artikullit; Shenjat dhe numrat identifikues; Numri dhe lloji i pakove; Përshkrimi i mallrave		Vendosni një përshkrim të detajuar të produkteve, në përputhje me dokumentin/et mbështetës/e dhe që lejon identifikimin e tyre. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në këtë kuti pa lënë asnjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e mbushur plotësisht, duhet të vendosni një vijë horizontale poshtë rreshtit të fundit të përshkrimit, duke kryqëzuar hapësirën boshe, d.m.th. me një vijë “në formë Z” në mënyrë që të

			përfshijë të gjitha mundësitë e shtesave mashtuese.
9	Pesha bruto (kg) ose nje masë tjetër (litra, m ³ , etj.)		
10	Faturat	Opsionale	Deklaroni numrin/at, nëse ka; datën/at e faturës/ave që lidhet/n me mallrat që janë mbuluar nga certifikata e lëvizjes EUR.1, kur është e mundur. Nuk është e detyrueshme ta bëni këtë.
11	Miratimi nga dogana		Kjo duhet të plotësohet nga doganieri. Vetëm për Doganat: si praktikë më e mirë, vendosni nr. DAV të deklaratës doganore të eksportit.
12	Deklarata nga eksportuesi	Vendi dhe data; Nenshkrimi	Cdo deklaratë duhet të jetë e saktë. Kushdo që bën një deklaratë të rreme në lidhje me origjinën preferenciale të mallrave, ose që nuk i përmbahet dispozitave të tjera ligjore mund t'i nënshtrohet penaliteteve.
			Shënim: Cdo ndryshim/korrigjim duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga deklaruesi në kutinë 12 dhe të miratohet nga Dogana.

Ju lutemi të keni parasysh se kutitë 13 dhe 14 janë të rezervuara në mënyrë strikte për përdorim nga autoritetet doganore në rastin e kontrolleve pas verifikimit.